

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Specialist** pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit / Sektori Sistemet ERP

SPECIALIST

Të mbështesë funksionimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e platformave ERP në organizatë. Të sigurojë integritetin dhe përputhshmërinë e proceseve të biznesit me sistemet ERP, si dhe të ofrojë mbështetje teknike dhe funksionale për përdoruesit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Administrimi i përditshëm dhe mirëmbajtja e sistemeve ERP të përdorura në organizatë (p.sh. SAP, Oracle, Microsoft Dynamics, etj.).
- Analiza e proceseve të brendshme dhe konfigurimi i moduleve ERP sipas kërkesave të departamenteve (Financë, Burime Njerëzore, Logjistikë, Operacione, etj.).
- Trajtimi i problemeve teknike dhe funksionale të lidhura me ERP dhe koordinimi me palët e treta kur nevojitet (furnitorë softuerësh).
- Testimi dhe dokumentimi i ndryshimeve në sistem, përfshirë përditësimet dhe integrimet e reja.
- Përcjellja e ciklit të jetës së kërkesave të reja (nga analizimi deri në zhvillim, testim dhe aktivizim).
- Ofrimi i trajnimeve dhe udhëzimeve për përdoruesit fundorë.
- Pjesëmarrja në projektet e migrimit, përmirësimit dhe zgjerimit të funksionaliteteve të ERP.
- Bashkëpunimi me zhvilluesit dhe specialistët e sistemeve për integrimin e ERP me aplikacione të tjera.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë në Informatikë Ekonomike, Teknologji Informacioni, Inxhinieri Kompjuterike, Administrim Biznesi ose fusha të ngjashme.
- Të paktën 2 vite përvojë me ERP në një rol funksional ose teknik.
- Njohuri të mira në një ose më shumë module ERP (Financë, Magazinë, HR, Asetet, etj.).
- Njohuri mbi proceset e biznesit dhe menaxhimin e dokumentacionit ERP.
- Njohuri në SQL dhe raportim (Crystal Reports, Power BI, ose mjetet e brendshme të ERP).
- Aftësi për të analizuar të dhëna dhe për të zgjidhur probleme komplekse teknike ose logjike.

Aftësi të dëshirueshme:

- Komunikim efektiv ndërdepartamental.
- Përqëndrim në detaje dhe menaxhim i mirë i kohës.
- Fleksibilitet për të punuar në projekte dhe afate të ndryshueshme.
- Njohuri mbi standardet e sigurisë së të dhënave dhe GDPR është përparësi.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.